



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 568 Prot.

Roskovec, më 30.01 2023

VENDIM

NR 10 .DATË 27.01 .2023

***“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.102, DATË 23.12.2022 “PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E STREHIMIT “PËRMIRËSIM I KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE, DERI NË NJË NDËRTIM TË RI”.***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, neni 24 pika 2 dhe neni 54, gërma “k”, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 15 dhe 16 ;Shkresës nr. 8552 prot, datë 14.05.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi sistemin online të strehimit dhe banesave sociale ;Shkresë nr.285/1prot, datë 13.09.2022 e Ministrisë së Brendshme “Për trajtimin e kërkesave për të përfutur nga programet e strehimit social nëpërmjet sistemit backend”, Këshilli i Bashkisë;

**VENDOSI :**

1. Një ndryshim në VKB Nr. 102, datë 23.12.2023 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Përmirësim i kushteve të banesave ekzistuese deri në një ndërtim të ri”, konkretisht ndryshohet tabela nr.1 – Formula e pikëzimit për aplikantët, e cila është bashkëlidhur vendimit.
2. Për secilin nga kushtet pikët maksimale janë 25 (pikë).
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është tabela nr.1, formula e pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, e ndryshuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

